

# Rolet dhe Përgjegjësitë e Trajnerit

Trajneri e ka një nga rolet kryesore në S4D. Trajneri është ai që do të jetë në kontakt të drejtpërdrejtë me pjesëmarrësit e rinj, dhe jo vetëm që do të ketë ndikim tek individët por edhe në komunitetet e tyre. Prandaj është thelbësore që të **jemi të vetëdijshëm për rolet dhe përgjegjësitë e shumta që duhet t'i përmbushë një trajner i mirë** dhe mënyrën si jua transmeton këto me sukses instruktorëve të ardhshëm si moderatorë të kurseve.

Si gjithmonë, duhet pasur parasysh se ekzistojnë pesë parime kryesore dhe se S4D mund ta zhvillojë potencialin e vetë të plotë vetëm nëse adresohen dhe zbatohen të gjitha parimet.



## Rolet e një trajnerit

Trajneri i S4D jo vetëm që duhet të jetë në gjendje t'ua përmirësojë shkathtësitë sportive pjesëmarrësve të rinj, por edhe më me rëndësi, ai duhet **të sigurojë që të katër dimensionet të zhvillohen (kognitive, sociale, sportive dhe fizike)** gjatë sesioneve të trajnimit të S4D. Për më shumë informata mbi këtë temë, shihkursin bazik mbi **Zhvillimin shumëdimensional**.

Bazuar në të kuptuarit bashkëkohor të mësimdhënies, ekzistojnë katër fusha të kompetencës të cilat trajneri duhet t'i balancojë vazhdimisht për të siguruar një sesion të suksesshëm trajnimi. Mbi të gjitha, **trajneri i S4D duhet gjithmonë të veprojë si model brenda dhe jashtë fushës**. Kjo nënkupton marrjen e përgjegjësisë për pjesëmarrësit e rinj, si dhe gatishmërinë për të mësuar dhe për t'u avancuar vazhdimisht si trajner dhe si person. Përveç kësaj, kreativiteti dhe përshtatshmëria janë shkathtësi të rëndësishme për trajnerët për t'i zhvilluar sesionet e trajnimit të S4D në përputhje me nevojat e pjesëmarrësve dhe kontekstin e caktuar. Nëse është e aplikueshme, trajnerët mund të marrin përgjegjësi shtesë në komunitetin e tyre përveç zhvillimit të sesioneve të trajnimit të S4D.

**Teknike:** Trajneri si **ekspert...**

- ✓ është në gjendje t'i mësojë dhe t'i zhvillojë kompetencat motorike, si dhe kompetencat teknike dhe taktike të pjesëmarrësve të rinj
- ✓ është në gjendje të shpjegojë, vlerësojë dhe zbatojë konceptin e përdorimit të sportit si një mjet për zhvillim

**Metodologjike:** Trajneri si **mësimdhënës...**


- ✓ krijon mundësi që pjesëmarrësit e rinj të mësojnë se si ta realizojnë një mendim të disiplinuar që është i qartë, racional, mendje-hapur, dhe të informuar nga dëshmitë
- ✓ i mëson pjesëmarrësit e rinj si ta vlerësojnë një situatë dhe ta zgjedhin një mënyrë veprimi nga disa mundësi
- ✓ i udhëzon pjesëmarrësit e rinj që ta definojnë një problem, ta analizojnë atë dhe t'i zhvillojnë strategjitë për ta shqyrtuar dhe zgjidhur problemin

**Organizative:** Trajneri si **planifikues dhe organizues...**

- ✓ është në gjendje të organizojë, planifikojë dhe strukturojë një sesion trajnimi/javor/sezonal në mënyrë efektive dhe në sekuenca
- ✓ e di se çfarë nevojitet për një aktivitet (p.sh. materiali, numri i pjesëmarrësve) dhe është në gjendje ta modifikojë dhe përshtatë një aktivitet në përputhje me rrethanat.

**Sociale:** Trajneri si **ndërtues ekipi, mentor, shok dhe këshilltar...**

- ✓ u mundëson pjesëmarrësve të rinj ta zhvillojnë dhe kultivojnë mendimin e solidaritetit që i mbështet idetë, vlerat dhe aktivitetet e të tjerëve



- ✓ u ofron mundësi pjesëmarrësve të rinj që t'i shprehin mendimet e tyre dhe i kyç ata në mënyrë aktive gjatë sesioneve të trajnimit
- ✓ i fuqizon pjesëmarrësit e rinj takuptojnë dinjitetin njerëzor si themel për të jetuarit së bashku, si dhe mbrojtjen e integritetit fizik dhe psikologjik

Kompetencat tjera që një trajner i S4D duhet t'i ketë mund t'i gjeni në ueb-faqen 'Sport for Development Resource Toolkit' nën: [Essentials – S4D Competences – Coach Competences](#), dhe nën: [Tools For Your Practice – S4D Teaching and Learning Materials – Palestinian Territories – Manual 'Kicking youth competences' \(p. 13-15\)](#).

Trajneri duhet të jetë në gjendje t'i marrë përsipër rolet e ndryshme. Rolet përkatëse duhet gjithmonë të zgjidhen në përputhje me kontekstin socio-kulturor në të cilin zhvillohen aktivitetet e S4D dhe duhet të bazohen në pjesëmarrësit e trajnimit. Deri sa **trajneri gjithmonë duhet të veprojë si model**, funksionet shitesë mund të varen nga grup-mosha e pjesëmarrësit. Sidoqoftë, rolet nuk janë përjashtuese. Trajneri gjithmonë duhet t'i marrë të gjitha rolet e nevojshme, duke i pasur parasysh ato më të rëndësishmet, që janë paraqitur në kutinë më poshtë.

#### Roli primar sipas grup-moshave

- **Nën 9:** Argëtues
- **9-12:** Mësimdhënës
- **13-16:** Ekspert
- **Mbi 16:** Shok

## Përgjegjësitë e trajnerit

Një nga përgjegjësitë kryesore të trajnerit të S4D është që ta **promovojë dhe të mundësojë zhvillimin e balancuar dhe afatgjatë të pjesëmarrësve të rinj**, duke i marrë parasysh nevojat fizike, psikologjike dhe personale të tyre.

Përveç kësaj, trajneri duhet të **sigurojë pjesëmarrje të vazhdueshme dhe kënaqësi tek pjesëmarrësit e rinj** duke iu ofruar një sërë aktiviteteve sfiduese dhe të larmishme.

Për t'i arritur këto synime, tabelat e mëposhtme ofrojnë disa udhëzime të rëndësishme të cilat trajneri duhet t'i përfillë kur bashkëvepron me të rinjtë në një mjedis të sportit për zhvillim. Këto udhëzime duhet të shtrihen sipas nevojës.

😊 Përpikuni t'i zbatoni	☹ Përpikuni t'i shmangni
✓ Përfshirja e pjesëmarrësve në procesin e planifikimit dhe vendimmarrjes	× Përjashtimi i pjesëmarrësve nga vendimet ose refuzimi i ideve të tyre
✓ Ndërgjegjësimi i pjesëmarrësve se një konflikt mund të ndodh dhe t'u ndihmoni që t'i zgjidhin problemet në mënyrë proaktive	× Bërja me gisht ose ngritja e zërit kur i kritikoni
✓ Lehtësimi i diskutimeve të hapura dhe të shprehurit e mendimeve	× Në vend që të përqendroheni në veprime/sjellje - pjesëmarrësit bëhen shënjestër e kritikave tuaja
✓ Planifikimi dhe vlerësimi i sesioneve të trajnimit	× Trajtimi i pjesëmarrësve në mënyrë të ndryshme ose të padrejtë

Është, po ashtu, përgjegjësi e trajnerit të jetë i vëmendshëm dhe ta **parandalojë çdo lloj të abuzimit ose keqpërdorimit të pjesëmarrësve të rinj**. Këtu përfshihet abuzimi fizik, emocional dhe seksual, si dhe neglizhimiose ngacmimi. Pajtimi për një **Kod të sjelljes** me pjesëmarrësit mund të jetë një mjet i dobishëm për të parandaluar një sjellje të tillë dhe për të krijuar një ndjenjë pronësie në mesin e të rinjve. Një mostër e Kodit të Etikës mund të gjendet në ueb-faqen 'Sport for Development Resource Toolkit' nën: [Tools For Your Practice – S4D Tools for Implementing Activities and Events – Guidelines – Guideline 'Code of Ethics Coach-Player'](#).